


# DITARI MUJOR <sup>MARS</sup> 2025

## ANSAMBLI ARKITEKTONIK URBAN - PESHKOPI

Qeveria Shqiptare miratoi vendimin për shpalljen e **“Ansamblit Arkitektonik Urban”** të një zone të qytetit të **Peshkopisë**, si pasuri kulturore e historike, së bashku me zonën mbrojtëse dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tij në bashkëpunim me Bashkinë Dibër.

Ky vendim i hap rrugë rijetëzimit të zonës, duke e kthyer atë në një qendër tërheqëse për turizmin kulturor dhe zhvillimin e qendrueshëm. Një investim për kujtesën dhe të ardhmen e qytetit, që synon të rikthejë shkëlqimin e tij historik, të përmirësojë infrastrukturën dhe të ruajë vlerat qytetare dibrane për brezat e ardhshëm!



# SARAJET E MYFIT BEUT - LIBOHOVË

**Libohovë, Sarajet e Myfit Beut** - një shembull i shkëlqyer i restaurimit të trashëgimisë sonë kulturore!



Ky projekt synon ndërhyrje konservuese në çatinë e objektit me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e degradimeve në këtë pasuri kulturore.

Në sajë të këtyre ndërhyrjeve, kjo ndërtesë i kthehet qytetit si një atraksion i shtuar turistik.



# SHPELLA E SHKRUAR E LEPENICËS

Dëshmia e vetme, deri më tani, e artit shkëmbor prehistorik në Shqipërinë Jugperëndimore, **Shpella e Shkruar e Lepenicës**, është shpallur në mbrojtje paraprake, një hap më pranë drejt shpalljes Monument Kulture i Kategorisë së Parë. Dokumentuar nga Prof. Dr. Muzafer Korkuti dhe ridokumentuar nga projekti shqiptaro-spanjoll “Lepenica”, kjo pikturë është krijim i rrallë i artit neolitik, që me ideogramat e tij dhe me mjetet dhe mënyrën e vet, ka paraqitur një “mesazh” të banorëve të kohës.



# KISHAT E VOSKOPOJËS

Specialistët e IKTK vijojnë ekspeditat në terren, duke mbikëqyrur dhe këshilluar ndërhyrjet restauruese në **kishat e Shën Marisë, Shën Mëhillit dhe Manastirin e Shën Prodhromit në Voskopojë.**

Në bashkëpunim me DRTK Korçë dhe kompaninë “Leon Konstruksion”, po realizohet konservimi i pikturës murale dhe ikonostaseve në kuadër të projektit për “Përmirësimin e turizmit potencial kulturor, nëpërmjet ndërhyrjes në sitet e trashëgimisë kulturore në Voskopojë”.

IKTK vazhdon monitorimin e kantierëve restaurues për të mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë tonë kulturore.



# PËRKUJTOHET GANI STRAZIMIRI

Themeluesi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Mbrojtjes të Institucioneve të Kultit në Shqipëri, **arkitekti Gani Strazimiri** është përkujtuar më 10 mars 2025, me rastin e 110-vjetorit të lindjes së tij, në një akademi solemne në hollin e Teatrit të Operas dhe Baletit, falë mbështetjes së shoqatës "Bashkësia Dibrane", Tiranë.

Vepra e arkitektit të mirënjohur, u vlerësua nga personalitete akademike, si Prof. Aleksandër Meksi, Prof. Dr. Neritan Ceka, Akademik Apollon Baçe, Prof. Dr. Pirro Thomo, Arkitekt Artan Shkreli etj.


Strazimiri luajti një rol kyç në shpalljen e Gjirokastrës dhe Beratit si qytete-muze, si dhe në mbrojtjen e pazareve historike të Krujës dhe Korçës. Ai ishte një mbrojtës i palodhur i trashëgimisë kulturore, duke ndikuar në ruajtjen e shumë objekteve fetare e historike që rrezikoheshin nga shkatërrimi. Emri i tij mbetet një simbol i përkushtimit dhe vizionit për mbrojtjen e identitetit kulturor shqiptar.



# PARKU KOMBËTAR BUTRINT

Specialistët e IKTK zhvilluan një inspektim në **Parkun Kombëtar të Butrintit** në kuadër të grupit të monitorimit të veprimtarisë së Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit (BMF), i ngritur me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ky proces synon të sigurojë zbatimin e standardeve më të larta për ruajtjen dhe menaxhimin e këtij siti të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore.



# STACIONI AD-QUINTUM

## **Stacioni Antik Ad Quintum** - Një Dëshmi Romake e Restauruar!

Termet dhe nimfeu i Bradasheshit, pjesë e rrugës Egnatia, janë një nga strukturat më të ruajtura romake në Shqipëri. Pas një procesi të plotë restaurimi, ky monument historik është rikthyer në gjendje optimale, duke ruajtur vlerat e tij për brezat e ardhshëm!

Ndërhyrjet restauruese përfshinë:

- Konsolidimin e strukturave;
- Qepjen e çarjeve me teknikën e injektimit;
- Forcimin e muraturës me llaç horasan;
- Rindërtimin dhe zgjerimin e mbulesës/çatisë së monumentit;
- Realizimin e sistemit të drenazhit;
- Pastrimin e fasadës nga depozitimet sipërfaqësore;
- Pastrimin nga vegjetacioni në të gjithë territorin;
- Vendosjen e një table informuese.



# KISHA E MANASTIRIT TË SHËN MËRISË, DHËRMI

## Kisha e Manastirit të Shën Mërisë në Dhërmi

ruan vlera të çmuara të artit bizantin dhe pasbizantin, me piktura murale të realizuara në disa faza, nga shek. XII-XIII deri në shek. XVIII.

Specialistët e IKTK zhvilluan një ekspeditë dokumentuese për hartimin e një projekti konservimi dhe restaurimi të pikturës murale.

IKTK vijon punën për mbrojtjen dhe restaurimin e veprave të artit në të gjithë territorin.





# PMI BERAT - GJIROKASTËR

Në kuadër të hartimit të **Planit të Menaxhimit të Integruar për qytetet e Beratit dhe Gjirokastrës**, një proces i mbështetur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, më 26-27 mars u zhvillua një vizitë në terren me pjesëmarrjen e ekspertëve të huaj nga Universiteti i Firences dhe CNR i Italisë, përfaqësuesve të Universitetit Politeknik të Tiranës, ekspertë të Universitetit të Tiranës, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat dhe Gjirokastrës.

Gjatë kësaj vizite, grupi i punës zhvilloi takime me institucionet lokale kyçe, të cilat do të jenë partnere në këtë proces, si dhe realizoi inspektime në sitet e trashëgimisë kulturore për të njohur më nga afër sfidat dhe potencialet e tyre.

Ky proces bashkëpunues synon të sigurojë një menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar të këtyre dy qyteteve historike, duke ruajtur dhe promovuar vlerat e tyre unike.

